



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 1055/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: : Milena Đerić kryesuese, Rustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e Astrit Sertolli, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Malishevës, nga subjekti politik Nisma Socialdemokrate, dega në Malishevë, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur me datë 07.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET i pabazuar apeli Anr.1055/2021 i datës 04.11.2021 i parashtruar nga Astrit Sertolli, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Malishevës, nga subjekti politik Nisma Socialdemokrate, dega në Malishevë, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal me të cilën ka kërkuar rinumëruar në vendvotimet 3029A/02D, 3037A/01R dhe 3046A/01R

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 04.11.2021, nga Astrit Sertolli, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Malishevës, nga subjekti politik Nisma Socialdemokrate, dega në Malishevë, me të cilën pretendon se në vendvotimet: 3029A/02D, 3037A/01R dhe 3046A/01R e kanë votuar të afërmit dhe miqtë e tij, mirëpo këto vota i mungojnë në rezultatet përfundimtare. Parashtruesi i apelit ka bashkangjitur kopje të dokumenteve identifikuese të votuesve, si dëshmi lidhur me pretendimet në apel.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të besueshmërisë së apelit dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

Paneli, vlerësoi se parashtuesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar asnjë dëshmi lidhur me shkeljet e supozuara lidhur me mungesën e votave të tij dhe pasqyrimin jo të drejtë të rezultateve edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur mos përfshirje apo mungesë të votave të parashtuesit të apelit, për faktin se thëniet e tij nuk mbështeten në asnjë provë konkrete por janë të përgjithshme e jo të konkretizuara, sepse pritjet e ankuesit për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mos përfshirje të saktë votave në rezultate përfundimtare, andaj pala ankuese nuk i ka argumentuar shkeljet e pretenduara në apel.

Si përfundim, Paneli vlerësoi se apeli i parashtruar nga Astrit Sertolli, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Malishevës, nga subjekti politik Nisma Socialdemokrate, nuk është bazuar në asnjë dëshmi bindëse në ndonjë formular të rezultateve apo ndonjë dëshmi të votuesve ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë regjistrimit të votave për kandidat, dhe si i tillë apeli vlerësohet si i pa bazuar.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli parashtruar nga Astrit Sertolli, nga subjekti politik Nisma Socialdemokrate, nuk është i bazuar me asnjë dëshmi ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje apo parregullsi gjatë numërimit të votave.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.1055/2021 më datën 07.11.2021

Kryesuese e Panelit
Mikena D. D. C.



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.